# Binas Nina

PROKUROR PRANË PROKURORISË SË RRETHIT GJYQËSOR ELBASAN

Deklaratat e analizuara:

**16 Deklarata të analizuara**

(nga deklarimi Për Herë të Parë 2003 deri Periodik/Vjetor 2018)

## Ndryshimi i pasurisë nga fillimi i deklarimit deri në vitin 2018




Pasuria bruto është rritur 3.2 herë.

+ 785,244 Lekë Rritja mesatare vjetore e pasurisë.

## Ndryshimi i pasurisë sipas kategorive

Vlera në Lekë

**Likuiditete në Bankë**




**Likuiditete në Cash**




**Pasuritë e Luajtshme**




**Pasuritë e Paluajtshme**




**Huadhënie**




## Të ardhurat familjare të krijuara gjatë periudhës deklaruese

| Të Ardhurat 2004-2018 | Shuma në Lekë | Raporti në % |
|---|---|---|
| Të ardhura nga paga nga funksioni | 18,041,586 | 54.9% |
| Të ardhura nga paga e bashkëshortes | 5,503,098 | 16.7% |
| Të ardhura nga shitja dhe rivlerësimi I pasurive të paluajtshme | 2,024,363 | 6.2% |
| Të ardhura nga mësimdhënia | 25,287 | 0.1% |
| Dhurata në cash | 855,528 | 2.6% |
| Të ardhura të tjera | 6,410,997 | 19.5% |
| Total | 32,860,859 | 100% |

## Kontrolli Aritmetik dhe Logjik

Kontrolli Aritmetik dhe Logjik për 15 vite rezultoi:

**Pa Probleme**

Në vitin 2009, subjekti Binas Nina deklaron huadhënie pa interes në vlerë 3,500,000 lekë, me burim financimi kursimet ndër vite. Huaja nuk rezulton të jetë kthyer sipas deklarimeve deri në vitin 2018.
Në vitin 2016, subjekti deklaron të ketë përfituar nga ligji numër 7501 datë 19.7.1991 tokë arë, në Bulzigë, si bashkëpronar me 1/6 pjesë takuese nga sipërfaqja 33,734 m2.
Në vitin 2017, subjekti deklaron të ketë përfituar nëpërmjet trashëgimisë ndërtesë në Elbasan, në bashkëpronësi me 1/6 pjesë të sipërfaqes totale 61 m2, pa deklaruar vlerë aseti. Në të njëjtin vit, ai deklaron kontrata dhurimi për pasurinë në fjalë.
Po në vitin 2017, subjekti deklaron dhurata në cash me vlerë 3,000 USD nga vëllai resident në Shtetet e Bashkuara për studimet e vajzës së tij në Boston.